



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E

FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË

USHQIMORE DHE TË USHQYERIT

PËR VITET AKADEMIKE
2019/2020; 2020/2021; 2021/2022

PËRMBAJTJA

1.	QËLLIMI I PROCESIT TË VETEUVALUIMIT	3
2.	PËRSHKRIMI I FAKULTETIT	4
2.1.	Historiku	4
2.2.	Misioni	5
2.3.	Strategjia e zhvillimit të fakultetit.....	6
3.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT	7
3.1.	Organogrami	7
3.2.	Programet studimore	10
4.	VEPRIMTARIA MËSIMORE	11
5.	STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR.....	17
6.	STRUKTURA E STUDENTËVE	18
7.	ANKETIMI I STUDENTËVE.....	22
8.	VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESEMARRJA NË PROJEKTE	26
9.	SWOT ANALIZA	30
10.	KONKLUZIONI	30

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEUVALUIMIT

Raporti i vetevaluimit është përgatitur në pajtim me nenin 55 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/18), me qëllim të përmirësimit të cilësisë së procesit arsimor në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit - Tetovë, Universiteti i Tetovës.

Qëllimi kryesor i procesit të vetevaluimit është që të bëhet një analizë cilësore e punës së Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, duke përdorur tregues të caktuar për përcaktimin e cilësisë së veprimtarisë së arsimit të lartë.

Në pajtim me Ligjin për arsim të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Statutin e Universitetit të Tetovës, Rregulloren për marrëdhënie të brendshme të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit – Tetovë, është formuar Komisioni për vetevaluim.

Në mbledhjen e mbajtur më 07.12.2020 me Vendim të Këshillit Mësimor - Shkencor të Fakultetit, Komisioni për Vetevaluim u zgjodh në këtë përbërje:

1. Xhabir Abdullahi - kryetar
2. Gafur Xhabiri - anëtar
3. Erhan Sulejmani - anëtar
4. Merie Elezi- anëtar
5. Rejhana Luma- anëtar

Sipas Ligjit për arsimin e lartë (neni 55), institucionet e arsimit të lartë përfshihen në procesin e vetevaluimit. Në veprimtarinë e arsimit të lartë organizohet vetevaluimi për programet e studimit pasuniversitar; për programet e studimit si dhe të vetevaluimit të personelit akademik.

Raporti i vetevaluimit është përgatitur në përputhje me “Udhëzimet për kriteret dhe metodën e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe personelit akademik në Republikën e Maqedonisë së Veriut”.

Vetevaluimi është një proces i vazhdueshëm me të cilin mund të bëhet një vlerësim real i cilësisë së procesit mësimor-edukativ nga disa aspekte, gjë që e bën atë të pashmangshëm dhe të

domosdoshëm për çdo institucion të arsimit të lartë. Duke e kuptuar rëndësinë e procesit të vetevaluimit, u punua në vazhdimësi dhe me një shkallë të lartë angazhimi.

U vendosën qëllimet e vetevaluimit, rezultatet e pritura të procesit të zbatuar dhe pjesëmarrësit sipas detyrave të tyre u përfshinë në procesin e vetevaluimit. Është aplikuar një analizë SWOT, e cila do të shërbejë si bazë për analizimin e pikave të forta, të dobëta, si dhe mundësive dhe kërcënimeve në zbatimin e procesit të arsimit.

Në procesin e vetevaluimit kanë kontribuar të gjithë punonjësit, dekanati, shërbimet administrative, stafi mësimor-kërkimor dhe studentët.

2. PËRSHKRIMI FAKULTETIT

2.1. Historiku

Në vitin 2008 me aprovimin e Ligjit të ri për Universitetin Shtetëror të Tetovës, u ndryshua dhe u plotësua Ligji për themelimin e USHT-së dhe u hap Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit me dy programe studimore:

- Teknologjia Ushqimore
- Të ushqyerit

Në vitin 2012 këto programe studimore u riakredituan dhe në vitin 2013 u themelua edhe programi studimor: Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore.

Më pas, në vitin akademik 2021/22 u akredituan programet në ciklin e parë:

1. Teknologjia Ushqimore (me 240 kredi);
2. Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore - u akreditua si program studimor me korrespondencë;
3. Programi studimor: Të ushqyerit, u emërua “Nutricioni”.

Programet në ciklin e dytë:

1. Teknologjia Ushqimore – u riakreditua;
2. Nutricioni – u akreditua si program i ri.

2.2. Misioni

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit (FTUU) kryen veprimtari mësimore-hulumtuese dhe bashkëpunim të jashtëm që zhvillohet në formë të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe bashkëpunim me kompanitë industriale ushqimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Vizioni i fakultetit të FTUU-së është arritja e përputhshmërisë me universitetet evropiane për të siguruar lëvizshmëri të studentëve dhe punësim më të madh në tregun evropian të punës.

Misioni (qëllimet dhe detyrat):

Për të realizuar vizionin e tij, fakulteti edhe gjatë kësaj periudhe ka ruajtur vazhdimësinë në synimet e përcaktuara:

- Zbatimi i teknologjisë arsimore sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS) në të dy ciklet e studimit;
- Përafrimi i përmbajtjeve lëndore sipas nevojave të industrisë;
- Përmirësimi i cilësisë së stafit mësimdhënës dhe kryerja e vazhdueshme e anketimit anonim të studentëve;
- Edukimi i kuadrove që do të jenë të gatshëm për të vepruar në fusha të ndryshme të ekonomisë brenda dhe jashtë vendit;
- Përgatitja e studentëve për pjesëmarrje në forma të ndryshme të punës shkencore dhe ekipore.

2.3. Strategjia e zhvillimit të fakultetit

Për të realizuar objektivat e tij, stafi akademik i fakultetit është përfshirë në të gjitha format e kërkimit dhe zotërimit të njohurive të reja për të zbatuar udhëzimet e procesit të Bolonjës:

- Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare për aplikimin e rezultateve të kërkimit shkencor në praktikën reale industriale;
- Ftesë për lektorë nga universitetet botërore për leksione në fushën e teknologjive.

Gjatë këtyre viteve, për këtë qëllim, dekanati ka ruajtur bashkëpunimin me fakultetet përkatëse si në rajon ashtu edhe më gjerë. Në periudhën raportuese, fakulteti, në përputhje me dispozitat ligjore për ofrimin e profesorëve vizitorë nga 500 universitete nga lista e Shangajit, pritën disa profesorë eminentë nga institute të ndryshme të arsimit të lartë, të cilët patën mundësinë të përcjellin te studentët dhe punonjësit një pjesë të njohurive dhe përvojës së tyre në fushën përkatëse.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, FTUU-ja vazhdoi angazhimin për hapjen e mundësive të reja për bashkëpunim me institucione të tjera arsimore nga Ballkani dhe më gjerë. Në këtë drejtim janë realizuar shumë aktivitete me keto universitete:

- ✓ Memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Shkencave të Jetës në Poznan, (Poznan, POLONI)
- ✓ Memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Bujqësisë në Nitra, (Nitra, SLOVAKI)
- ✓ Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Tomas Bata në Zlín, (Zlín, REPUBLIKA ÇEKE)
- ✓ Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Ordu, (Ordu, TURQI)
- ✓ Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Osmanije Korkut Ata (Osmanie, TURQI)
- ✓ Universiteti i Shkencave Bujqësore dhe Mjekësisë Veterinare të Cluj Napoca-s.

Njohuritë e marra nga bashkëpunimi me universitetet botërore, transmetohen përmes punës në seminare, simpoziume, konferenca, të botuara në broshura dhe përmes dokumenteve të miratuara të Këshillit mësimor dhe shkencor.

Rekomandim për avancim: Të vazhdohet me ndjekjen e synimeve strategjike të fakultetit.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogram

Organet e Fakultetit të Teknologjise Ushqimore dhe të Ushqyerit janë:

- Këshilli mësimor-shkencor
- Dekani
- Dekanati

Këshilli mësimor-shkencor është organ drejtues i fakultetit. Këshilli mësimor përbëhet nga profesorë të rregullt dhe me kohë të pjesshme dhe nga profesorë asistentë që janë të punësuar në fakultet. Përfaqësuesit e studentëve të zgjedhur nga Parlamenti Studentor, nga radhët e studentëve të rregullt në fakultet, marrin pjesë në punën e Këshillit mësimor- shkencor.

Dekanati është organi drejtues që e përfaqëson fakultetin brenda dhe jashtë vendit në përputhje me Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e Fakultetit. Kompetencat e dekanatit përcaktohen me ligj, me Statutin e Universitetit dhe me Rregulloren e Fakultetit.

Administrata e dekanatit është organi drejtues i fakultetit dhe përbëhet nga: dekani, prodekanët, drejtuesit e departamenteve, si dhe një anëtar i zgjedhur nga asambleja studentore e fakultetit.

Sekretari i fakultetit merr pjesë në punën e dekanatit pa të drejtë vendimmarrjeje. Fakulteti ka 2 (dy) prodekanë, të cilët zgjidhen nga Këshilli mësimor - shkencor i Fakultetit me propozimin e dekanit:

- Prodekani për arsim
- Prodekani për shkencë

Menaxhimi

Dekan	Prof. Dr. Xhezair Idrizi
Prodekan për arsim	Prof. Dr. Gafur Xhabiri
Prodekan për shkencë	Doc. Dr. Erhan Sulejmani
Sekretar	Mr. Sc. Vigan Sulejmani

Tabela 1. Stafi menaxhues i FTUU-së

Shefa të programeve studimore

Programi studimor: Teknologji Ushqimore	Mr. Sc. Durim Alija
Programi studimor: Të ushqyerit	Doc. Dr. Gafur Xhabiri
Programi studimor: Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	Doc. Dr. Namik Durmishi

Tabela 2. Shefat e programeve studimore në FTUU

Koordinator per ECTS kreditë

Koordinator për ECTS kredi	Mr. Sc. Hava Mitari
----------------------------	---------------------

Tabela 3. Koordinatorë për ECTS kredi në FTUU

Anëtarët e Këshillit mësimor-shkencor

1. Prof. Dr. Xhezair Idrizi
2. Prof. Dr. Xhabir Abdullahu
3. Prof. Dr. Fejzullah Fejzulla
4. Prof. Dr. Erhan Sulejmani
5. Prof. Dr. Namik Durmishi
6. Prof. Dr. Gafur Xhabiri
7. Prof. Dr. Ismail Ferati
8. Prof. Dr. Merije Elezi

Tabela 4. Anëtarët e Këshillit mësimor-shkencor në FTUU

Kuadri mësimor dhe administrativ

Kuadri mësimor (gjendja sipas thirrjeve)

1. Prof. Dr. Xhezair Idrizi – profesor ordinar
2. Prof. Dr. Xhabir Abdullahu - profesor ordinar
2. Prof. Dr. Fejzullah Fejzulla - profesor ordinar
3. Prof. Dr. Erhan Sulejmani – profesor inordinar
4. Prof. Dr. Namik Durmishi - profesor inordinar
5. Prof. Dr. Gafur Xhabiri - profesor inordinar
6. Prof. Dr. Ismail Ferati - profesor inordinar
7. Prof. Dr. Merije Elezi - profesor inordinar
8. Mr. Sc. Durim Alija – asistent
10. Mr. Sc. Hava Miftari – asistent

Tabela 5. Kuadri mësimor në FTUU

Sekretar	Mr. Sc. Vigan Sulejmani
Referent për çështje studentore	Albina Sadiku
Referent për çështje studentore	Arita Karai
Referent për çështje studentore	Bekim Nuhiu

Tabela 6. Kuadri administrativ në FTUU

Laborantët e angazhuar me kontratë pune:

Emri dhe mbiemri	Statusi:
1. Safije Medija	laborant
2. Rejhana Luma	laborant

Tabela 7. Laborantët e angazhuar me kontratë pune në FTUU

Studentët:

Cikli I:

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin e parë:	31
Teknologji Ushqimore:	15
Nutricion:	3
Menaxhim me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore:	13
Shtetas të huaj:	6

Tabela 8. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin e parë, në ciklin I në FTUU

Cikli II:

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin e parë:	27
Teknologji Ushqimore:	20
Nutricion:	7
Shtetas të huaj:	6

Tabela 9. Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin e parë, në ciklin II në FTUU

a. Programet studimore

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, funksionon nga viti 2008.

FTUU-ja, ka tri programe studimore në ciklin e parë si dhe dy programe studimore në ciklin e dytë.

Studimet themelore zgjasin 3/4 vjet, me mundësi akumulimi të 180/240 ECTS kredive, kurse studimet *master* zgjasin 2 vjet dhe me mundësinë e akumulimit të 120 ECTS kredive.

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit ka laboratorin i cili u shërben studentëve për analiza të ndryshme profesionale si dhe laboratorin tjetër që është në procedurë akreditimi me pajisjet më bashkëkohore për kontrollin e produkteve ushqimore, që është donacion i ambasadës italiane.

Cikli I

PROGRAMI	S	ECTS	KUALIFIKIMI	DESKRIPTORËT
TEKNOLOGJI USHQIMORE	240		Inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore	Deskriptori
MENAXHIMI ME CILËSINË DHE SIGURINË USHQIMORE	180		Inxhinier i menaxhimit me cilësinë dhe sigurinë ushqimore	Deskriptori
NUTRICIONI	180		Nutricionist i diplomuar	Deskriptori

Cikli II

PROGRAMI	S	ECTS	KUALIFIKIMI
Nutricioni	120		Magjister i nutricionit
TEKNOLOGJI USHQIMORE	120		Magjister i teknologjisë ushqimore

Tabela 10. Programet studimore në FTUU në ciklin I dhe II

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit procesin mësimor e realizon në kuadër të tri programeve studimore të akredituara në vitin **2013** dhe atë të ciklit të parë: Teknologji Ushqimore 180 ECTS; Të ushqyerit 180 ECTS; Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore 180 ECTS dhe programin studimor të ciklit të dytë Teknologji Ushqimore 120 ECTS.

Ndërsa në vitin **2021** FTUU-ja ka riakreditur dhe akredituar programet studimore të ciklit të parë dhe atë: Teknologji Ushqimore 240 ECTS; Nutricioni 180 ECTS; Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore 180 ECTS dhe programet studimore të ciklit të dytë: Teknologji Ushqimore 120 ECTS dhe Nutricioni 120 ECTS.

FTUU-ja procesin mësimor e realizon në këto objekte: një amfiteatër, tri salla mësimore, katër laboratorë dhe pjesë tjera ndihmëse si: 5 zyra për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët, një zyrë e administratorëve si dhe dy zyra të dekanatit. Gjithashtu në kuadër të fakultetit funksionon edhe Laboratori për kontrollin e produkteve ushqimore me 4 njësi ku studentët realizojnë një pjesë të ushtrimeve. Për realizimin e pjesës mësimore, fakulteti disponon 4 projektorë dhe 2 laptopë.

	Lloj i objektit	Numri
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe Të ushqyerit		
	Amfiteatër	1
	Salla mësimi	3
	Laboratorë	4
	Zyra për stafin akademik	5
	Zyra e administratës	1
	Dekanati	2
	Laboratori për analizat e produkteve ushqimore	4
	Gjithsej	20

Tabela 11. Hapësirat në FTUU

Në programet studimore të akredituara në vitin 2013 pjesëmarrja dhe raporti i lëndëve obligative, zgjedhore dhe opsionale është si më poshtë:

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
<i>Programi studimor: Teknologji Ushqimore</i>			
1	Obligative	24	60.0
2	Zgjedhore	12	30.0

3	Opsionale	4	10.0	Cikli i parë
Gjithsej		40	100%	

Tabela 12. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në FTUU

- Në programin studimor *Teknologji Ushqimore*, studentët ndjekin dhe kalojnë gjithsej 40 lëndë mësimore nga të cilat 24 janë lëndë obligative, 12 lëndë zgjedhore dhe 4 lëndë opsionale. Sipas përfaqësimit në %, 60.0% janë lëndë obligative, 30.0% lëndë zgjedhore dhe 10.0% lëndë opsionale.
- Gjithashtu në programin studimor *Të ushqyerit*, pjesëmarrja dhe raporti i lëndëve obligative, zgjedhore dhe opsionale është e njëjtë si në programin studimor *Teknologji Ushqimore*.

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
<i>Programi studimor: Të ushqyerit</i>			
1	Obligative	24	60.0
2	Zgjedhore	12	30.0
3	Opsionale	4	10.0
Gjithsej		40	100%

Tabela 13. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Të ushqyerit

- Në programin studimor *Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore* studentët ndjekin dhe të kalojnë gjithsej 37 lëndë mësimore nga të cilat 22 janë lëndë obligative, 11

lëndë zgjedhore dhe 4 lëndë opsionale. Sipas përfaqësimit në %, 59.45% janë lëndë obligative, 29.72% lëndë zgjedhore dhe 10.81% lëndë opsionale.

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
<i>Programi studimor: Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore</i>			
1	Obligative	22	59.45
2	Zgjedhore	11	29.72
3	Opsionale	4	10.81
Gjithsej		37	100%

Tabela 14. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
<i>Programi studimor: Teknologji Ushqimore</i>			
1	Obligative	8	66.6
2	Zgjedhore	3	25.0
3	Opsionale	1	8.33
Gjithsej		12	100%

Tabela 15. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Teknologji Ushqimore

Cikli i dytë

Në programet studimore të akredituara në vitin 2021 pjesëmarrja dhe raporti i lëndëve obligative dhe zgjedhore është si më poshtë:

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
Programi studimor: Teknologji Ushqimore			
1	Obligative	38	76.0
2	Zgjedhore	12	24.0
Gjithsej		50	100%

Tabela 16. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Teknologji Ushqimore, në vitin akademik 2021

Cikli i parë

- Në programin studimor *Teknologji ushqimore* studentët ndjekin dhe kalojnë gjithsej 50 lëndë mësimore nga të cilat 38 janë lëndë obligative dhe 12 janë lëndë zgjedhore. Sipas përfaqësimit në %, 76.0% janë lëndë obligative dhe 24.0% lëndë zgjedhore.
- Në programin studimor *Nutricioni* pjesëmarrja dhe raporti i lëndëve obligative dhe zgjedhore është 28 lëndë obligative apo 70.0% dhe 12 lëndë zgjedhore apo 30.0%. gjithsej duhet të ndjekin dhe kalojnë 40 lëndë mësimore.

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
Programi studimor: Nutricioni			
1	Obligative	28	70.0
2	Zgjedhore	12	30.0
Gjithsej		40	100%

Tabela 17. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Nutricioni

- Në programin studimor *Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore*, studentët ndjekin dhe të kalojnë gjithsej 40 lëndë mësimore nga të cilat 27 janë lëndë obligative

dhe 13 lëndë zgjedhore. Sipas përfaqësimit në %, 67.5% janë lëndë obligative dhe 32.5% janë lëndë zgjedhore.

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
Programi studimor: Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore			
1	Obligative	27	67.5
2	Zgjedhore	13	32.5
Gjithsej		37	100%

Tabela 18. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore

Cikli i dytë

- Në programet studimore të ciklit të dytë *Teknologji Ushqimore* dhe *Nutricioni*, pjesëmarrja dhe raporti i lëndëve obligative dhe zgjedhore është i njëjtë. Respektivisht studentët duhet të ndjekin dhe të kalojnë gjithsej 19 lëndë mësimore nga të cilat 13 janë lëndë obligative dhe 6 janë lëndë zgjedhore. Sipas përfaqësimit në %, 68.43% janë lëndë obligative dhe 31.57% janë lëndë zgjedhore.

Nr.	Lëndët	Nr. i lëndëve	% e përfaqësimit
Programi studimor: Menaxhimi me cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore			
1	Obligative	13	68.43
2	Zgjedhore	06	31.57
Gjithsej		19	100%

Tabela 19. Lëndët obligative, zgjedhore dhe opsionale në programin studimor Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore

5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR - SHKENCOR

Struktura e kuadrit mësimor - shkencor në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

Procesi mësimor në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit realizohet nga 8 mësimdhënës dhe 2 bashkëpunëtorë që janë në marrëdhënie të rregullt pune dhe një mësimdhënës, një bashkëpunëtor dhe dy demonstratorë me kontratë në vepër. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët kanë kaluar në procese zgjedhjesh dhe rizgjedhjesh në përputhje me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës.

Nga tetë mësimdhënës të rregullt, një është profesor ordinar, dy janë profesorë inordinarë dhe pesë janë docentë, ndërsa për nga gjinia shtatë janë të gjinisë mashkullore dhe vetëm një e gjinisë femërore. Moshë e mësimdhënësve është e ndryshme, një është në moshën 62-vjeçare, një është në moshën 52-vjeçare, një 51-vjeç, një 49-vjeç, dy 45-vjeç, një 44-vjeç dhe një 43-vjeç. Bashkëpunëtorët janë të moshës 30-vjeçare.

Sa i takon mbarëvajtjes së mësimin, të gjithë mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët realizojnë pjesën e ligjëratave dhe ushtrimeve me një fond të plotë orësh javore sipas shkallës akademike-shkencore që kanë, në tri programet studimore të akredituara, dhe atë: Teknologji Ushqimore; Të ushqyerit; Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët kryesisht mësimin e realizojnë në lëndët profesionale, ndërsa realizimi i mësimin te lëndët e përgjithshme realizohet nga mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë nga fakultetet tjera në kuadër të Universitetit të Tetovës.

Meqenëse dy nga bashkëpunëtorët e rregullt që kemi janë në studime të doktoratës, planifikojmë që në të ardhmen të rrisim numrin e demonstratorëve, bashkëpunëtorëve të jashtëm (që një pjesë janë ish-studentët tanë të cilët kanë përvojë praktike nga ndërmarrjet ushqimore prodhuese ku punojnë) për realizimin e pjesës së ushtrimeve dhe më andej me anë të hapjes së konkurseve t'i pranojmë edhe si bashkëpunëtorë të brendshëm.

MËSIMDHËNËS									
Të rregullt	Meshku j	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej

Ordinar	1	/	49	1	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	6	1	62,43, 52,51,45,45, 44	7	Inordinar	/	/	/	/
Docent	/	/	/		Docent	/	/	/	/
					Ligjërues (dr.sc)	1	/	48	1
Gjithsej	7	1	/	8		1			1

Tabela 20. Struktura e mësimdhënësve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22

	BASHKËPUNËTORË								
Të rregullt	Meshku j	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshku j	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	1	1	30,30	2	Asistent	/	1	34	1
Asistent i ri	/	/	/	/	Asistent i ri	/	/	/	/
Demonstrator	/	/	/	/	Demonstrator	/	2	37,23	2
Gjithsej	1	1		2			1		3

Tabela 21. Struktura e bashkëpunëtorëve sipas thirrjeve mësimore-shkencore dhe gjinisë në vitet akademike 2019/20; 2020/2021 dhe 2021/2022.

6. STRUKTURA E STUDENTËVE

Fakulteti ynë, viteve të fundit ka pasur një organizim të bujshëm rreth promovimit të fakultetit. Krahas ofertës akademike që shkon për çdo vit akademik, pedagogët dhe bashkëpunëtorët e tyre për realizimin e pjesës praktike të mësimit, organizojnë vizita të ndryshme me ndërmarrjet prodhuese ushqimore në vend dhe më gjerë, ku me një pjesë më të madhe të këtyre ndërmarrjeve kanë nënshkruar edhe memorandum bashkëpunimi. Gjithashtu

duke filluar nga ky vit akademik si një risi tjetër nga FTUU-ja është organizimi i panairit të produkteve ushqimore në kuadër të ditëve të hapura pranë Universitetit të Tetovës. Gjithashtu nga viti 2018 FTUU-ja filloi edhe me shtypjen e numrit të parë të revistës shkencore International Journal of Food Technology and Nutrition.

Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitet akademike 2019/20; 2020/21 dhe 2021/22, të ciklit të parë me kohëzgjatje të studimeve prej tri viteve është 98, ndërsa në ciklin e dytë është 11.

Numri i studentëve në tri vitet akademike të cilat i janë nënshtruar analizës, ndryshon në varshmëri të programeve studimore. Nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar, pjesa më e madhe e tyre është e regjistruar në programin studimor Teknologji Ushqimore (46 studentë - 46.93%), ndërsa në programin studimor Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë ushqimore (35 studentë - 35.71%), te programi i Të ushqyerit numri i studentëve të regjistruar është më i vogël (21 - 17.34%). Nga të dhënat e paraqitura, shihet që në vitin e fundit akademik 2011/22, numri i studentëve në programin studimor Teknologji Ushqimore në raport me vitin paraprak është relativisht i njëjtë.

Cikli i parë i studimeve

Viti akademik 2019/20

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	20	/	/	20	2	/
2	Të ushqyerit	/	/	/	/	/	/
3	Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	14	/	/	14	/	/

Tabela 22. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2019/2020

Viti akademik 2020/21

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	11	/	/	11	1	/
2	Të ushqyerit	9	/	/	9	/	/
3	Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	11	/	/	11	2	/

Tabela 23. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021

Viti akademik 2021/22

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	15	/	/	15	/	/
2	Të ushqyerit	8	/	/	8	3	/
3	Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	5	5	/	10	/	/

Tabela 24. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2021/2022

Nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në programin e vetëm të ciklit të dytë Teknologji Ushqimore, për tri vitet akademike 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22 është 11 (100%).

Karakteristike është se në vitin akademik 2019/20 dhe 2020/21 kemi numër të ngjashëm të studentëve, ndërsa brengos fakti se për vitin akademik 2021/22 nuk kemi studentë të regjistruar.

Cikli i dytë i studimeve

Viti akademik 2019/20

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	6	/	/	6	1	/

Tabela 25. Numri i përgjithshëm i studentëve në ciklin II në vitin akademik 2019/2020

Viti akademik 2020/21

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	5	/	/	5	/	/

Tabela 26. Numri i përgjithshëm i studentëve në ciklin II në vitin akademik 2020/2021

Viti akademik 2021/22

	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Projekt 35/45	Gjithsej	SH.H.	Nacionaliteti
1	Teknologji Ushqimore	/	/	/	/	/	/

Tabela 27. Numri i përgjithshëm i studentëve në ciklin II në vitin akademik 2021/2022

Raporti mes mësimdhënësve dhe studentëve në të gjitha vitet akademike 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22 është i kënaqshëm. Nënkuptohe se ky raport më i ulët është te programi studimor Teknologji Ushqimore.

Programi studimor	Numri i	Numri i	Raporti

	Viti akademik	studentëve	mësimdhënësve në marrëdhënie të rregullt	mësimdhënës - student
Teknologji Ushqimore	2019/20	20	8	0.4
	2020/21	11	8	0.72
	2021/22	15	8	0.53
Të ushqyerit	2019/20	/	8	/
	2020/21	9	8	0.88
	2021/22	8	8	1
Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore	2019/20	14	8	0.57
	2020/21	11	8	0.72
	2021/22	10	8	0.8

Tabela 28. Raporti i mësimdhënësve dhe studentëve në vitet akademike 2019/2020; 2020/2021 dhe 2021/2022


7. ANKETIMI I STUDENTËVE

Anketimi i studentëve

Studentët e FTUU-së kanë dhënë vlerësim mbi procesin mësimor të realizuar gjatë periudhës akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022. Ata janë përgjigjur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë, veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje, studentët janë përgjigjur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1, që nënkupton se

dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5 ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.


Studentët e FTUU-së gjithsej kanë dhënë 125 vlerësime, duke përfshirë të gjitha vitet studimore. Në nivel të fakultetit, në të gjithë indikatorët, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe i ligjëruar ($M = 4.35$). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M=4.15$) dhe ushtrimeve ($M=4.25$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Lidhshmëria e materialit për përdorim praktik, gjatë orëve të ligjëratave është vlerësuar pozitivisht me ($M=4.1$) kurse gjatë orëve të ushtrimeve është vlerësuar me ($M = 4.2$). Mësimdhënësit gjatë orëve të ligjëratave kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar ($M=4.11$), gjatë ushtrimeve niveli i qartësisë është shprehur me ($M=4.23$).



Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin e FTUU-së

Në programin studimor Teknologji Ushqimore, gjithsej janë dhënë 42 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.66$). Studentët kanë dhënë vlerësim të lartë pozitiv për nivelin e informimit gjatë


ligjëratave lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, (M=4.93). I njëjti nivel pozitiv është dhënë edhe për orët e ushtrimeve (M=4.90). Vlerësim pozitiv është dhënë edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjëratë, (M=4.86), kurse gjatë ushtrimeve vlerësimi lidhur me qartësinë shprehet në një nivel edhe më të lartë (M=4.93); lidhshmëria e përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive në ligjëratë edhe në ushtrime është pozitive (M=4.95), (M=4.93). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave (M = 4.97) dhe ushtrimeve (M = 5.00) është i saktë sipas orarit të planifikuar. (Grafikoni 2). Nga të dhënat e paraqitura mund të shihet qartë që vlerësimi për të gjitha kategoritë e vlerësuara është tejet i lartë.



Grafikoni 2. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Teknologji Ushqimore


Në programin studimor Menaxhim me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore, gjithsej janë dhënë 35 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar (M=4.29). Studentët kanë dhënë vlerësim mesatar pozitiv për nivelin e informimit gjatë ligjëratave lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, (M=3.71), kurse gjatë ushtrimeve niveli i informimit paraqet një tendencë të uljes (M=3.62). Vlerësim mesatar pozitiv

është shprehur edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata dhe ushtrime, ($M=3.86$); lidhshmëria e përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive në ligjërata edhe në ushtrime është mesatarisht pozitive ($M=3.71$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave dhe ushtrimeve ($M = 3.66$) është në nivel mesatar kundrejt orarit të paraparë të ligjëratave dhe ushtrimeve.



Grafikoni 3. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë Ushqimore

Në programin studimor Nutricioni, gjithsej janë dhënë 28 vlerësime. Studentët të cilët u janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M=4.26$). Studentët kanë dhënë vlerësim mesatarisht pozitiv për nivelin e informimit gjatë ligjëratave lidhur me aktivitetet dhe përgjegjësitë e lëndës, ($M=3.75$), kurse gjatë ushtrimeve niveli i informimit paraqet një tendencë të rritjes ($M=3.90$). Vlerësim mesatarisht pozitiv është shprehur edhe për qartësinë e mësimdhënësve në ligjërata dhe ushtrime, ($M=3.72$), ($M=3.82$); lidhshmëria e përmbajtjeve me përdorim praktik të njohurive gjatë ligjëratave është mesatarisht pozitive ($M=3.71$), kurse gjatë ushtrimeve paraqet një tendencë të rritjes ($M=3.96$). Studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave dhe ushtrimeve ($M = 4.00$); ($M=4.11$) realizohet saktë sipas orarit të paraparë. (Grafikoni 4).



Grafikoni 4. Vlerësimi i procesit mësimor në programin studimor Nutricioni

8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Rritja e numrit të projekteve të kontraktuara nga jashtë të mbështetura nga BE-ja dhe nga ministritë, është e vazhdueshme në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit (FTUU). Projektet e kontraktuara në këtë fushë vazhduan në vitin 2019/20/21/22. Më datë 16.07.2020 zyrtarisht përfunduar me sukses projektin IFCHEESE “Fokus inovativ në djathin natyror malor me bimë aromatike duke mbrojtur metodat tradicionale të prodhimit” i koordinuar nga Universiteti Ardahan dhe me partneritetin, IED në Greqi, Instituti IMS i Qipros, Universiteti Munzur Tunceli, Elelmiszer Klubi i Hungarisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë Ushqimore të Ardahanit me mbështetjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Bashkimit Evropian të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë dhe Agjencisë Kombëtare Turke në kuadër të Programeve Rinore Erasmus+ Partneriteti Strategjik KA2 u mbyll me sukses.

Në vitin 2019 fituam projektin në kuadër PROGRAMI ERASMUS+, KA2 - Bashkëpunim për inovacion dhe shkëmbim praktikash, KA205-Partneritete Strategjike për të rinjtë, 2018-3-TRO1-KA205-061518 me autoritetin menaxhues Agjencia Kombëtare Turke, Qendra për Bashkim Evropian, Edukim dhe Programe të Rinisë me kohëzgjatje 24 muaj/1.03.2019- 28.02.2021 dhe zgjatje shtesë prej 12 muajsh për shkak të pandemisë Covid-19 dhe me buxhet prej 179 077 eurove.

Objektivi i projektit kishte për qëllim rritjen e punësimit të gjinisë femërore, nëpërmjet kultivimit të luleve si dhe punësimit të të rinjve të cilët janë ekspertë dhe kompetentë në artizanat përmes artit dhe teknologjive inovative.

Aktivitetet e projektit dhe rezultatet intelektuale ishin:

1. Përmirësimi i standardeve të jetesës dhe zhvillimit ekonomik të grave të reja të papuna nëpërmjet “Metodave të prodhimit të luleve në vend dhe në Evropë” (O1)
2. Përdorimi efektiv i artit (muzikës dhe teknologjisë në kultivimin dhe marketingun e luleve (O2)
3. Teknikat e marketingut përmes shërbimeve online nga vajzat e reja që prodhojnë (O3)
4. Dokumentar filmik me metrazh të shkurtër “ART BLOSSOM”.

Ekipi i projektit ka kryer studime, kërkime dhe trajnime në sektorin e florikulturës me institucionet partnere. Këto aktivitete përbëhen nga: 3 takime ndërkombëtare: Turqi, Itali, Maqedoni e Veriut, 3 trajnime profesionale: Maqedoni e Veriut, Italia dhe Turqia, 3 konferenca profesionale: Bullgari, Maqedoni e Veriut, të cilat janë të shpërndara dhe përdoren në mënyrë të qëndrueshme në vendet dhe rajonet partnere të projektit. Rezultatet e projektit janë të disponueshme për individët e talentuar që duan të marrin pjesë në sektorin e florikulturës si sipërmarrës.

FTUU-ja monitoron të gjitha proceset e menaxhimit përmes Auditimit të Brendshëm dhe merr masat e nevojshme korrigjuese/zhvilluese për të përmirësuar kulturën e bashkëpunimit. Në këtë drejtim, u vendos që të fillojë akreditimi i ciklit të dytë dhe të tretë për të përhapur kuptimin e cilësisë në arsim në të gjitha programet në FTUU dhe për t’u ofruar njësive konsulencë, u formua Bordi dhe Komisioni i Monitorimit të Akreditimit.

FTUU-ja i jep përparësi monitorimit dhe marrjes së masave në mënyrë që proceset e edukimit dhe trajnimit të mund të zhvillohen dhe të qëndrojnë. Gjithashtu, institucioni kryen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e menaxhmentit të lartë dhe palëve të interesuara për të forcuar aspektet që janë të hapura për përmirësim të specifikuar në Raportin e Akreditimit Institucional 2021. Përpjekjet për përhapjen dhe sistemimin e këtyre aktiviteteve vazhdojnë.

Komisioni për Vlerësim i FTUU-së u krijua dhe filloi punën e tij me qëllim monitorimin e efektivitetit të praktikave me në qendër studentin. Në studimet e akreditimit të programit, u prezantua sistemi i mentorimit ndërmjet njërive. Studimet mbi efektivitetin e sistemit të këshillimit akademik janë ndër aspektet që janë të hapura për përmirësim.

Mungesa e një procesi sistematik për përcjelljen e të diplomuarve është identifikuar në raportin e mëparshëm si një fushë e hapur për përmirësim. Në këtë drejtim, janë nisur studimet për të siguruar komunikimin me të diplomuarit nga FTUU-ja dhe për mbledhjen dhe monitorimin sistematik të të dhënave, zhvillon vazhdimisht softuerin, i cili monitoron proceset e menaxhimit të cilësisë. Ky softuer do të lejojë monitorimin efektiv të të gjitha dokumenteve, reagimet nga palët e interesuara dhe proceset e kryera nga njësitë. FTUU-ja merr komentet e palëve të interesuara dhe kryen veprime korrigjuese në përputhje me pikëpamjet e palëve të interesuara. Në vitin 2021, Institucioni kërkoi opinionin e palëve të interesuara në mënyrë që të zgjerojë fushëveprimin e fushave dhe të shtojë fusha të reja midis fushave të tij prioritare. Institucioni merr masa për të rritur kapacitetet e tij kërkimore dhe zhvillimore. Nevoja për një sistem për monitorimin e rezultateve të studimeve ndërdisiplinore vazhdon në FTUU.

FTUU-ja inkurajon mbështetjen e aktiviteteve kërkimore përmes projekteve, informon rregullisht palët e interesuara për aplikimet e projekteve dhe organizon trajnime.

Departamenti për shkencë ka një pozicion kyç në menaxhimin e proceseve kërkimore duke kryer studime përmirësimi në fushat e fokusimit të kërkimit mbi problemet lokale dhe rajonale, duke siguruar pjesëmarrjen e aktorëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të projekteve si vlerësues, duke i bërë të dukshme informacionet dhe rezultatet e kërkimit në faqet e internetit të njësisë akademike dhe u shërben qëllimeve strategjike të Universiteti në këtë fushë. Informon studiuesit për projektet e jashtme në institucion dhe për realizimin e projekteve.

Politika e kërkimit të FTUU-së në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e performancës kërkimore të institucionit, monitoron aktivitetet kërkimore sipas renditjes së Indeksit Novativ dhe Sipërmarrës, renditjes së pikëve të nxitjes akademike, renditjes së Universitetit sipas performancës akademike. FTUU-ja vlerëson performancën e kërkimit përmes renditjes së universiteteve botërore të arsimit dhe statistikave të Web of Science. FTUU-ja në mbështetje nga Zyra për Shkencë dhe Inovacion, ndjek automatikisht publikimet nëpërmjet përkrahjes dhe

përshirjes së stafit në sistemet e databazave shkencore (Google Scholar, ORCI, Scopus). Në dritën e këtyre vlerësimeve, bëhen rregullimet/përmirësimet e nevojshme institucionale për të arritur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu inkurajohet pjesëmarrja në kërkimet e kryera nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare për të rritur ndikimin dhe njohjen ndërkombëtare të kërkimit me origjinë nga FTUU-ja dhe për të siguruar dukshmëri në këtë mënyrë. Në vazhden e këtij bashkëpunimi mbanen rregullisht takime për promovimin e kërkimeve dhe arritjeve si dhe inkurajohet publikimi i rezultateve të kërkimit në revista ndërkombëtare.

1. Hapësirat

2. Hapësirat:	m²
4 Hapësira laboratorike	70 m ²
3 Mësonjëtorë	3 x 30m ²
Zyra e dekanit të fakultetit	30m ²
Zyra e sekretarit të fakultetit	20m ²
4 zyra të mësimdhënësve të fakultetit	4 x 20m ²
Zyra e administratës së fakultetit	20m ²
Zyra e laborantëve të fakultetit	20m ²

Tabela 29. Hapësirat në FTUU

9. SWOT ANALIZA

Aplikimi i SWOT analizës për parametrat më të rëndësishëm të përfshirë në procesin evaluimit.

Përparësitë	Të metat
- Staf mësimor i konsoliduar; - Disponueshmëria e mësimdhënësve dhe studentëve përmes komunikimit elektronik; - Karakteri multidisiplinor i stafit mësimor; - Numri i lëndëve për mësimdhënësit për semestër është në përputhje me kushtet e përcaktuara me Ligjin për arsim sipëror; - Numri i orëve për bashkëpunëtorë për semestër është në kushtet e parashikuara me ligj; - Shërbimet administrative në nivel; - Kyçje në rrjetin e projekteve për bashkëpunim dhe partneritet strategjik; - Bashkëpunimi me ndërmarrjet prodhuese; - Botimi i revistës shkencore IJFTN që nga viti 2018 dhe indeksimi.	- Inkurajimi ose mbështetja e pamjafrueshme e aktiviteteve kërkimore; - Mungesa e punësimit të stafit të ri; - Vështirësi në gjetjen e fondeve; - Nevoja për akreditimin e programeve të reja të ciklit të dytë dhe të tretë; - Infrastruktura e papërshtatshme e zyrave të mësimdhënësve.
Mundësitë	Kërcënimet
- Можности за обука за учество и аплицирање во проекти; - Можност студентите да завршат практична работа во прехранбената индустрија во регионот; - Зголемување на потребата на индустријата за соработка со факултетот.	- Немање критериуми за оценување, наградување и санкционирање; - Недостигот од наставни простори го загрозува квалитетот на образовниот развој; - Отворање слични студиски програми и на други факултети во државата.

Табела 30. SWOT анализа на ФПТИ

10. KONKLZIONI

Me sublimimin e të dhënave të marra është përgatitur një raport i cili është mjaft i qartë, konciz dhe pasqyron pamjen reale të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit.

Procesi i zbatuar i vetevaluimit të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore ka rezultuar nga detyrimi për vetëvlerësim të Universitetit, gjegjësisht të njësive të Universitetit, në përputhje me nenin 77 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Realizimi i vetevaluimit është një punë shumë e gjerë dhe e përgjegjshme, por edhe e nevojshme për monitorimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore-shkencore të arsimit të lartë.

Pas kryerjes së procedurës së vetevaluimit, Komisioni nxori disa përfundime:

- Procesi i vetevaluimit duhet të kryhet në vazhdimësi dhe të përfshijë të gjitha segmentet e funksionimit të institucionit të arsimit të lartë;
- Të dhënat e përfshira në Raportin e vetevaluimit duhet të jenë objektive dhe të pasqyrojnë realisht situatën aktuale;
- Paraqitja joobjektive e parametrave të përfshirë në procesin e vetevaluimit do të pasqyrojë gabimisht situatën aktuale dhe në këtë mënyrë do të zvogëlojë mundësinë reale të eliminimit të dobësive në operacion;
- Procesi i vetevaluimit duhet pranuar pozitivisht, pa rezistencë dhe distancim nga dobësitë e konstatuara në funksionimin e institucionit;
- Raporti i vetevaluimit t'i paraqitet dekanatit dhe Këshillit mësimor-shkencor nga institucioni dhe të pranohet prej tyre;
- Dobësitë e evidentuara, të cilat janë kryesisht të natyrës së jashtme apo subjektive, duhen parë si nxitje dhe arsye për zgjidhjen e problemeve.